



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-019
Prishtinë, më 4 maj 2015, në orën 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 4 MAJ 2015

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Aida Dërguti, Jasmina Zhivković dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Glauk Konjufca, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Milosavljeviq, Valdete Bajrami dhe Myfera Shinik, si dhe anëtarët e Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër korrupsionit: Albulena Haxhiu, Selviqe Halimi dhe Armend Zemaj.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Valon Xhaferi;

Nga Administrata e Kuvendit: Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri (3) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryetari në fillim i njoftoi anëtarët e Kryesisë se me kërkesë të kryetares së Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, znj. Albulena Haxhiu, janë ftuar për të marrë pjesë në këtë mbledhje të Kryesisë edhe tre anëtarë të këtij komisioni: Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit, Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit, si dhe Armend Zemaj, kryesues i Nënkomisionit për Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit.

Ai tha se tema e diskutimit për të cilën janë ftuar anëtarët e komisionit të lartpërmendur është: Harmonizimi i veprimeve lidhur me procedimin e Projektligjit për Kuvendin dhe procedimi i projekt-Rregullores për Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Lidhur me procedimin e Projektligjit për Kuvendin dhe procedimin e projekt-Rregullores për Kuvendin e Republikës së Kosovës, diskutuan: Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Selvije Halimi, Sabri Hamiti, Adem Grabovci dhe Ismet Beqiri, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve të lartpërmendura, konstatoi se e mbështet Komisionin për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit për hartimin dhe procedimin e Projektligjit për Kuvendin dhe të projekt-Rregullores për Kuvendin e Republikës së Kosovës gjatë sesionit pranveror.

Më pas, Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 14 dhe 15 prill 2015,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 14 dhe 15 prill 2015

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 14 dhe 15 prill 2015.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë me pikën e mbetur nga mbledhja e Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 30 mars 2015, dhe diskutuar në mbledhjen e Kryesisë, më 14 prill 2015 - Propozim-rezoluta e Grupit Parlamentar të PDK-së për të vënë drejtësi për gjenocidin dhe krimet e luftës të kryera nga Serbia ndaj popullsisë së

zbardhur fatin e personave të zhdukur gjatë luftës.

Kryesia, pasi diskutoi për pikën e lartshënuar, vendosi që për këtë çështje të pritët me qëllim të harmonizimit të Rezolutës së lartshënuar me grupet parlamentare dhe pastaj kjo rezolutë të procedohet për shqyrtim në njërën nga mbledhjet e radhës së Kryesisë.

* * *

Më pas, Kryesia, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e radhës të mbahet më 6 maj 2015, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për të përmirësuar pajtueshmërinë e rregulloreve tatimore në nivel ndërkombëtar dhe zbatimin e rregulloreve FATCA,
5. Emërimi i anëtarëve të Bordit të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për pajisje me armë, municion dhe pajisje përkatëse të sigurisë për institucionet e autorizuar shtetërore për siguri,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për armë,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për letërnjoftim,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokatin e Popullit,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për barazi gjinore,
13. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga diskriminimi,
14. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trashëgiminë kulturore,
15. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Provimin e Maturës Shtetërore *(debati ka përfunduar në seancën e mëparshme)*,
16. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për digjitalizimin e transmetimeve radiodifuzive tokësore,
17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mbikëqyrjen elektronike të personave të cilëve u kufizohet lëvizja me vendim të Gjykatës ose Panelit për Lirim me Kusht,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
19. Emërimi i shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore,
20. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin e qytetarëve të Rahovecit për ndriçimin e fatit të Ukshin Hotit,
21. Rekomandimet e Komisionit për të Drejta të Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione lidhur me peticionin kundër shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike,
22. Debat parlamentar lidhur me gjendjen e arsimit në Luginën e Preshevës, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, mbështetur edhe nga gjashtë (6) deputetë tjerë,
23. Shqyrtimi i raportit të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2014,
24. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2014,

26. Shqyrtimi i raportit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës për vitin 2014,
27. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2014,
28. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2014,
29. Shqyrtimi i raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2014,
30. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social,
31. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për investimet e huaja,
32. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës nga radha e komunitetit serb.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave

1. Korniza afatmesme e shpenzimeve, 2016-2018

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se në mbledhjen e mbajtur më 15 prill 2015, Kryesia e Kuvendit e ka miratuar në parim Kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitet 2016-2018.

Ai tha se ndërkohë këtë kornizë e ka shqyrtuar edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, i cili ka bërë disa ndryshime në të dhe i ka rekomanduar Kryesisë së Kuvendit miratimin e saj.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Kornizën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Korniza afatmesme e shpenzimeve e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për vitet 2016-2018.
2. I rekomandohet Ministrisë së Financave që e njëjta të përfshihet në Kornizën afatmesme të shpenzimeve për vitin 2016-2018.

2. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës nga radha e komunitetit serb

Kryesia, pasi diskutoi për pikën e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

1. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 6 maj 2015, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e (1) një anëtar të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nga radha e komunitetit serb.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet si në vijim: GP i PDK-së, 2 anëtarë, GP i LDK-së, 2 anëtarë, GP VV, 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP Lista serbe, 1 anëtar, GP "Nisma", 1 anëtar dhe GP "6+", 1 anëtar.

3. Propozim-deklarata për transparencë parlamentare

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me deklaratën e lartshënuar, nxori këtë:

Përfundim

I. Kryesia e Kuvendit zotohet se do të angazhohet në përmbushjen e standardeve ndërkombëtare të transparencës parlamentare të parapara në Deklaratën për transparencë parlamentare.

II. Formohet Forumi për transparencë parlamentare, në këtë përbërje:

1. Zenun Pajaziti, deputet, GP i PDK-së,
2. Salih Morina, deputet, GP i LDK-së,
3. Shqipe Pantina, deputete, GP i LVV-ja,
4. Donika Kada-Bujupi, deputete, GP i AAK-së,
5. Sërgjan Popoviq, deputet GP i LS,
6. Valdete Bajrami, deputete, GP “Nisma”,
7. Fikrim Damka, deputet, GP i “6+”,
8. Shqipe Krasniqi, zyrtare e Administratës së Kuvendit,
9. Fehmi Hyseni, zyrtar i Administratës së Kuvendit,
10. Vullnet Kabashi, zyrtar i Administratës së Kuvendit,
11. Jetmir Bakija, Instituti Demokratik i Kosovës (KDI),
12. Petrit Zogaj, Lëvizja FOL,
13. Visar Rushiti, Instituti GAP.

III. Forumi për transparencë parlamentare do ta përgatisë Planin e veprimit për transparencë parlamentare dhe në koordinim me kryetarin e Kuvendit dhe sekretarin e përgjithshëm përkujdeset për implementimin e tij.

4. Kërkesa e Komisionit për Integritet Evropian për organizimin e Konferencës Rajonale lidhur me sfidat drejt procesit të integritetit dhe roli i Kuvendit në këtë proces

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Komisionit për Integritet Evropian për organizimin e Konferencës Rajonale lidhur me sfidat drejt procesit të integritetit dhe roli i Kuvendit në këtë proces, e cila do të mbahet më 2 qershor 2015.

2. Shpenzimet e akomodimit për shtatë (7) kryetarët e komisioneve homologe nga rajoni, që do të ftohen për të marrë pjesë në konferencën e paraparë në pikën (1) një të këtij vendimi, mbulohet nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Kërkesa e kryetares së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, për lejimin e udhëtimit zyrtar të këtij komisioni në Shqipëri dhe në Mal të Zi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohen udhëtimi i anëtarëve të Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, në këtë përbërje: Flora Brovina, Njomza Emini, Fikrim Damka, Fadil Beka, Hatim Baxhaku, Besa Baftija, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi, si dhe Muhamet Bytyçi nga stafi mbështetës i komisionit, në Shqipëri dhe në Mal të Zi, që do të realizohen gjatë muajit maj 2015.

2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

6. Propozimi për formimin e Grupit punues për hartimin e Planit strategjik të Kuvendit për periudhën 2015-2020

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me Propozimin e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

I. Formohet Grupi i Punës për hartimin e Planit strategjik për Kuvendin e Republikës së Kosovës për periudhën 2015-2020, në këtë përbërje:

1. Ismet Krasniqi, Administrata e Kuvendit, kryesues,
2. Gëzim Kasapolli, anëtar,
3. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar i PDK-së, anëtar,
4. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar i LDK-së, anëtar,
5. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar i VV-së, anëtar,
6. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar i AAK-së, anëtar,
7. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar i LS-së, anëtar,
8. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar NISMA, anëtar,
9. Përfaqësues nga Grupi Parlamentar “6+”, anëtar,
10. Përfaqësues nga Grupi i Grave Deputete, anëtar,
11. Përfaqësues nga OSBE-ja, anëtar,
12. Përfaqësues nga UNDP-së, anëtar,
13. Përfaqësues nga GIZ-it, anëtar,
14. Përfaqësues nga NDI-ja, anëtar,
15. Përfaqësues nga DCAF-i, anëtar,
16. Xheladin Hoxha, Administrata e Kuvendit, anëtar,
17. Emrush Haxhiu, Administrata e Kuvendit, anëtar,
18. Përfaqësues nga shoqëria civile, anëtar,
19. Shqipe Krasniqi, Administrata e Kuvendit, koordinatorë e procesit.

II. Për hartimin e Planit Strategjik të Kuvendit të Republikës së Kosovës për periudhën 2015-2020, Grupi i Punës do ta ketë mbështetjen profesionale dhe ekspertizën e nevojshme nga Franklin De Vrieze, ekspert/UNDP-së.

III. Grupit të punës do t’i bashkohen edhe drejtorët e drejtorive të Administratës së Kuvendit, sipas kërkesës së kryesuesit të Grupit Punues.

7. Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me Buxhetin e Komunës së Prishtinës për vitin 2015

Kryetari i Kuvendit i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Komisioni për Buxhet

nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, më 24 shkurt 2015. Ai tha se këtë buxhet Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka proceduar në Ministrinë e Financave, që të pasqyrohet në tabelat buxhetore të Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

8. Raporti i Komisionit për Legjislacion lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, prej 2-3 prill 2015

Kryesia u njoftua për vizitën zyrtare të realizuar nga Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në Shqipëri, prej 2-3 prill 2015.

Pikat shtesë:

Nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti, kërkoi nga Administrata e Kuvendit që në të ardhmen të mos procedojë me pika shtesë, të cilat nuk janë të përfshira në rendin e ditës për mbledhje të Kryesisë së Kuvendit.

Kryesia e mbështeti propozimin e nënkryetarit të Kuvendit, z. Sabri Hamiti, që në mbledhjet e ardhshme të Kryesisë së Kuvendit të mos procedohen pika shtesë në fillim të mbledhjes.

1. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtarë në Mal të Zi

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i anëtarëve të Komisionit Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, në këtë përbërje: Nait Hasani, Salih Morina, Jelena Bontiq, Ismajl Kurteshi, Bekim Haxhiu, Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu, Shukrije Bytyqi dhe Myfera Shinik, si dhe nga stafi mbështetës i Komisionit, Lule Ymeri dhe Shaip Guxhuli, në Mal të Zi, prej datës 11-12 maj 2015.

2. Shpenzimet e fjetjes për të lartshënuarit në pikën (1) një të këtij vendimi mbulohen nga organizatori, ndërsa shpenzimet e transportit, ushqimit dhe mëditjeve shtesë, si dhe të gjitha shpenzimet për (1) një vozitës të Kuvendit mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

2. Kërkesa e Kooperativës Bujqësore “KRUSHA”, nga Krusha e Madhe, Rahovec

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa në shumën prej tremijë e tetëqind (3800) euro për Kooperativën Bujqësore “KRUSHA”, nga Krusha e Madhe, Rahovec.

2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere.

3. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që mjetet e lejuara në pikën një (1) të këtij vendimi t'i derdhë në xhirrollogarinë e bashkangjitur, me nr. 4232600413503300.

3. Kërkesa e Parlamentit Studentor të UP-së

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet pagesa në shumën prej njëmijë (1 000) euro për Parlamentin Studentor të UP-së.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere.
3. Ngarkohet Administrata e Kuvendit që mjetet e lejuara në pikën një (1) të këtij vendimi t'i derdhë në numrin e xhirollogarisë së bashkangjitur.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë në orën 13:35 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale